

KONKLuzionet nga Konferenca:

"E ARDHmJA E PROCESIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR nga KONFLIKTI NË KOSOVË"

I
CMP organizoi konferencën me titull "E ardhmja e procesit të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë", në Shkup, Maqedoni, më 20-21 nëntor 2012. Konferenca ishte e dyta e këtij lloji që nga konferenca e parë e tillë në Ohër në vitin 2007 ku u mbledhën të gjitha palët e përfshira në procesin e personave të zhdukur, duke përfshirë autoritetet përkatëse nga Prishtina dhe Beogradi, familjet e të zhdukurve dhe komuniteti ndërkombëtar. Takimi arriti të ju mundësojë pjesëmarrësve të tij që të vlerësojnë gjendjen e procesit të personave të zhdukur, ku qëndron procesi, duke përfshirë: ndjekjet penale për krime lufte, legjislacionin për persona të zhdukur, krijimin e bazave të të dhënave dhe regjistreve qendrore, funksionimi i institucioneve vendore, si dhe zhvarrimet dhe identifikimet.

Në konferencë, ICMP vuri në dukje se ka pasur përpjekje intensive për të gjetur dhe identifikuar personat e zhdukur nga konflikti në Kosovë pas publikimit të raportit të tij rreth situatës në Kosovë në shtator të vitit 2010. ICMP ka vërejtur zhvillime pozitive si miratimi i Ligjit për Personat e Zhdukur dhe legjislacionit dytësor. ICMP vuri në dukje megjithatë, se, pavarësisht nga përpjekjet më të mira të EULEX-it dhe të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës ka pasur një rënie të vazhdueshme që nga viti 2006 në gjetjen e mbetjeve mortore në territorin e Kosovës dhe nuk ka mbetje mortore të tjera të gjetura në territorin e Serbisë që nga viti 2002. Deri më sot ICMP ka perputhur me ADN 2418 raste, ose 55 për qind, nga 4,383 raste të raportuara të personave të zhdukur në regjistrin e saj. Por nga viti në vit numri i identifikimeve të reja ka pesuar renje: në 2009 ICMP ka bërë 106 identifikime të reja, në vitin 2010 88, në vitin 2011 58, dhe deri në nëntor 2012 vetëm 30. Procesi është ngadalësuar dhe do të bëhet gjithnjë e më i ngadalshëm në vitet e ardhshme.

Konkluzionet e konferencës poshtë përmbledhin mendimet dhe ndjenjat e familjeve të të zhdukurve të cilët morën pjesë në konferencë.

Konkluzionet

1. Institucionet relevante të Prishtinës dhe Beogradit duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të marrë informacion mbi vendndodhjen e varrezat klandestine përfshirë kërkimin nëpër të gjitha arkivat dhe përdorimin e mundshëm të imazheve satelitore dhe të gjitha mjetet tjera në dispozicion/të teknologjive moderne në mënyrë që të rrisë operacionet e tyre në terren, dmth gërmimet dhe zhvarrosjet në kordinim me bashkësinë ndërkombëtare .
2. Çështja e varrezave që lidhen me konfliktin e Kosovës jashtë territorit të Kosovës duhet të trajtohen bashkarisht nga autoritetet përkatëse nga Prishtina dhe Beogradi në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare.
3. Për një sërë arsyesh, duke përfshirë faktin që personat u zhduken pergjate të gjithë kufijve gjeopolitikë, një listë e personave të zhdukur nga konfliktet në ish-Jugosllavi në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të duhet të krijohet e cila do të përfshijë listën e konsoliduar të Kosovës të personave të zhdukur. Ideja për krijimin e listës së përbashkët regjionale duhet kohë dhe hapsirë për sqarime të mëtutjeshme. ICMP duhet të ju ofroj Komisioneve sqarime të mëtutjeshme.
4. Me iniciativën e shoqatave familjare si dhe me ndërmjetsimin e institucioneve ndërkombëtare të organizohen takime të shpeshta të shoqatave familjare me institucionet e Beogradit dhe Prishtinës.
5. E lëjm të hapur mundësinë që në të ardhmen të diskutohet për përkujtimet e përbashkëta dhe përmendoret.

6. Ofrimi i trajnimeve për familjet e personave të pagjetur në përdorimin e ligjeve për qasje në informata me karakter publik me qëllim të marrë informacion në lidhje me personat e zhdukur dhe varrezave klandestine.
7. Duhet të krijohen kushtet dhe të veprohet sipas parimit të drejtësisë që kriminelët të gjykohen në vendin e krimit. Krijimi i mekanizmeve për bashkëpunim më të mirë midis prokurorit të gjykatës për krime lufte të Republikës së Serbisë dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe vendor që merren me rastet e krimeve të luftës që lidhen me konfliktin në Kosovë.
8. Forcimi i programit të mbrojtjes së dëshmitarëve, duke marrë parasysh ndikimi potencial që dëshmia e dëshmitarit mund të ketë për përcaktimin e vendndodhjes së varrezat klandestine që përmbajnë mbetjet mortore të personave të zhdukur.
9. Fillimi i dialogut për procesin e personave të zhdukur në mes të autoriteteve relevante të Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel nën kujdesin e Bashkimit Evropian.
10. Mbështetje për formimin e një ekipi të përbashkët operativ të ngarkuar me trajtimin e çështjes së personave të zhdukur që do të përfshijë institucionet relevante të Prishtinës dhe Beogradit me praninë e shoqatave familjare për persona të zhdukur.
11. Prezenca e ICMP në Kosovë duhet të vazhdojë edhe pas mandatit të EULEX-it që skadon më 2014.
12. Të formohet grupit punues i cili do të angazhohet në revidimin e përgjithshëm të të gjithë personave të cilët janë identifikuar me metodën klasike pa analizë të ADN-së.